



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

11 maj 2010, Prishtinë

## VENDIM I KËSHILLIT TË KPM-SË LIDHUR ME VLEFSHMËRINË E LICENCAVE TË PËRKOHSHME

Në pajtim me nenin 11.3 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim (**Ligji Nr. 02/L-15**), KPM ka përmbyllur procesin e licencimit afatgjatë. Megjithatë, ka mbetur një numër I vogël I subjekteve transmetuese të cilat nuk kanë vepruar në pajtueshmëri të plotë me pakon e aplikacionit për licencë afatgjate, respektivisht nuk kanë arritur të instalojnë filtrin dalës si një prej kushteve kryesore teknike për licencim.

Në takimin e Këshillit të KPM-së, të mbajtur më 7 maj 2010 është marrë vendim që licencat e përkohshme të lëshuara nga Komisioneri i Përkohshëm për Media, të konsiderohen të vlefshme deri më 30 qershor 2010. Pas këtij afati, të gjitha licencat e përkohshme do të konsiderohen të pavlefshme ndërsa subjektet transmetuese të cilat nuk janë pajisur me licencë afatgjate, në pajtim me nenin 20.5 të Ligjit për KPM-në obligohen të ndërpresin transmetimin.

Këshilli i KPM-së, UDHËZON të gjitha ato subjekte transmetuese (radio dhe TV stacionet) të cilat deri më tani nuk kanë arritur ta bëjnë instalimin e filtrit dalës, që të ndërmarrin hapat e duhur për të vepruar në pajtim me përmbushjen standardeve kushteve teknike, duke e instaluar filtrin dalës në afat sa më të shkurtë dhe ta njoftojnë me kohë KPM-në për një veprim të tillë. Në këtë mënyrë, subjektet e tilla transmetuese mund të pajisen me licencë afatgjate dhe të vazhdojnë veprimtarinë e tyre transmetuese.

Këshilli i KPM-së është zotuar se pas afatit të përcaktuar me këtë vendim, do të ndërmerr të gjitha masat e duhura ligjore për të ndërprerë transmetimin ilegal për të gjitha subjektet transmetuese të cilat nuk arrijnë të pajisen me licencë afatgjate të KPM-së.

Agim Sopi  
Anëtar i Këshillit të KPM-së

KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA



Ref:1005/0638/KKPM/II